

**Çështjet fetare në hapësirat shqiptare dhe siguria jonë kombëtare.
Realiteti dhe sfidat.¹**

Nga Xhavit Shala

Të nderuar organizatorë të konferencës!

Të nderuar pjesëmarrës!

Është kënaqësi për mua t'i drejtohem këtij auditori të nderuar për një çështje mjaft të rëndësishme për ne shqiptarët. Vlerat kombëtare fetare të shqiptarëve janë të mirënjohura dhe të vlerësuara në Perëndim. Janë vlera të cilat Perëndimi pret që ne t'i përcjellim në familjen e përbashkët evropiane ku po synojmë të integrohemi.

Por si u krijuan këto vlera? A janë të rrezikuara këto vlera dhe nga kush? A duhen sigurizuar ato, pra a duhen mbrojtur me masa të veçanta? Cili është realiteti dhe sfidat që na presin?

Këtyre pyetjeve do të përpiqem t'i jap përgjigje në kumtesën time.

Çështjet fetare në hapësirat shqiptare janë të lidhura ngushtë me sigurinë tonë kombëtare. Prandaj ruajtja e vlerave kombëtare fetare të shqiptarëve është një obligim i shqiptarëve kudo që ndodhen, në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Malin e Zi, Camëri, Preshevë-Medvegj e Bujanovc si dhe në diasporë.

Këto vlera fetare u formësuan paralelisht me Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, nën kujdesin e veçantë të rilindësve tanë dhe në kushte specifike, të ndryshme nga kombet e tjera në Ballkan.

1. Besimet fetare kanë luajtur një rol mjaft të rëndësishëm në lëvizjet kombëtare të disa vendeve ballkanike.

¹ Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore me temë: "Ruajtja e vlerave kombëtare fetare të shqiptarëve" mbajtur në Shkup, me 3 Shtator 2010. Konferenca është organizuar nga Agjencia e Lajmeve INA dhe Fakulteti i Shkencave Islame në Shkup, Maqedoni.

Krahas ideve kombëtare, besimi fetar i përbashkët, motivi fetar u bë një faktor i rëndësishëm që i afronte shpirtërisht elementët përbërës të këtyre popujve dhe që shpejtoi bashkimin e tyre kombëtar në luftën çlirimtare kundër pushtuesve osmanë, **të cilët ishin myslimanë**, pra të një feje tjetër nga ajo e tyre. Kështu mund të thuhet për serbët, grekët, malazezët², bullgarët, etj. Meqë popullsia e këtyre vendeve i përkiste të njëjtit besim fetar, udhëheqja e lëvizjes së tyre kombëtare përfitoi nga antagonizmi fetar me sundimtarët osmanë për ta përdorur kishën si forcë ideologjike dhe agjitatore në lëvizjen çlirimtare. Kështu, në Serbi vetë kisha ortodokse serbe ka luajtur një rol të veçantë në themelimin e shtetit serb.³

Tendenca për të identifikuar lidhjet e ngushta fetare me një grup specifik etnik, nga njëra anë dhe liria relative fetare brenda Perandorisë Otomane, nga ana tjetër, u kombinuan për t'i bërë kishat lokale si simbole qendrore të formësimit të nacionalizmit brenda Ballkanit.

Kështu, Kisha Latine nuk ishte vetëm një element i rëndësishëm që i bëri kroatët të ndryshëm nga serbët, por edhe një pikë grumbullimi për nacionalizmin kroat përballë nacionalizmit serb. Në të njëjtën mënyrë, Kisha Ortodokse Serbe u bë fokusi i nacionalizmit serb deri në ditët e sotme. Historikisht, kisha ortodokse serbe ka luajtur një rol të veçantë në themelimin e shtetit serb. Pushteti i saj u ruajt edhe gjatë pushtimit osman. Ajo mbliidhte taksa nga besimtarët dhe zotëronte pasuri të tundshme dhe të patundshme.

Besimi i njëjtë fetar u siguroi lëvizjeve kombëtare të këtyre vendeve me popullsi ortodokse edhe aleatë të fuqishëm strategjikë, siç ishte Rusia cariste. Prej saj ata morëm mbështetje jo vetëm diplomatike, por edhe ushtarake.

² Për rreth 3 shekuj, Mali i Zi drejtohej nga princa-peshkopë, të cilët kishin pushtet politik dhe kishar. Kjo u jepte mundësinë atyre që të përdornin edhe besimin fetar për t'i angazhuar njerëzit kundër pushtuesve osmanë.

³ Nën petkun paqësor, kisha serbe siguronte komunikimin midis ortodoksëve sllavë, sidomos me rusët, si dhe drejtonte rezistencën antiosmane. Realisht, serbët, në këto kushte, kishën e shikonin si shtetin e tyre. Madje, edhe mbledhja e parë e qeverisë serbe, menjëherë pas shkëputjes nga Perandoria Osmane, 200 vjet më parë, u bë në në manastirin Voljevça, afër Kragujevacit. (Për më tepër shih: Xhavit Shala, "Kisha serbe dhe paqja negative në Kosovë", botuar në në gazetën «Tiranaobserver», dt. 14 mars 2006 dhe në www.acnss.com)

2. Por cili ishte raporti i besimeve fetare të shqiptarëve me lëvizjen kombëtare shqiptare?

Deri në mes të shekullit XIX, Fuqitë e Mëdha nuk ishin çliruar akoma nga koncepti mesjetar i kombit, i cili identifikohet jo vetëm me territorin, gjuhën, kulturën, **por edhe fenë**. Për këtë, opinioni evropian nuk arrinte ta pranonte se dy pjesë me fe të ndryshme, të një kombësie (siç ishin shqiptarët e krishterë dhe shqiptarët myslimanë), të konsideroheshin si pjesëtarë të një kombi të vetëm.

Veç kësaj ka edhe një tjetër faktor historik që ka peshuar rëndë në çështjen kombëtare shqiptare. Deri në mes të shekullit XIX, në opinionin evropian mbisundonte bindja se **kontinenti historikisht i takonte fesë së krishterë**. Si rrjedhim, turqit myslimanë, për pasojë edhe myslimanët jo turq të Ballkanit, ishin, për këtë opinion, mish i huaj në trupin e kontinentit. Gjithnjë sipas këtij opinioni, vetë turqit duheshin përzënë, të paktën jashtë Europës. Si rrjedhim, ky opinion e kishte të vështirë të pranonte krijimin e një shteti mysliman (qoftë edhe jo turk), në gjirin e kontinentit evropian. Në shkrimet e botuara gjatë shekullit XIX, ndeshet shpeshherë teza se krijimi i një shteti shqiptar mysliman, ishte baras me krijimin e një Turqie të vogël, e cila do të vazhdonte të mbijetonte në Ballkan, kur Turqia do të dëbohej jashtë kontinentit. Këtë opinion u përpoqën të krijojnë në ditët e sotme serbët për të penguar krijimin e shtetit të pavarur të Kosovës.

Shqiptarët kohë më parë, që me Karamahmut pashë Bushatlliun dhe me Ali pashë Tepelenën, krijuan faktorët e nevojshëm për të formuar shtete shqiptare. Por ato nuk u njohën e nuk u mbështetën si pasojë e alergjisë që kishin Fuqitë e Mëdha evropiane për një shtet me popullsi myslimane në Europë.

Kjo platformë u shfrytëzua edhe nga qarqet nacionaliste të krishtera ballkanike, të cilat në këtë mënyrë justifikonin copëtimin dhe aneksimin e trojeve shqiptare midis tyre, si e vetmja rrugë për të penguar mbijetesën e “Turqisë” në Ballkan.

Argumentet për këtë tezë i dha **vetë Perandoria Osmane me konceptin që ajo kishte mbi kombësinë dhe identitetin kombëtar të një populli**. Perandoria Osmane si shtet teokratik islamik vazhdonte ta llogariste **fenë si përbërësin kryesor të identitetit kombëtar të një populli**. Në Perandorinë Osmane vazhdonte të mbisundonte koncepti, sipas të cilit, të gjithë myslimanët që bënin pjesë brenda kufijve të saj, pavarësisht nga gjuha, nga traditat, nga historia e tyre, po që kishin përqafuar fenë islame, duhej ta konsideronin veten **pjesëtarë të kombësisë osmane**⁴. Për analogji, nga rrethi i kombësisë islamike përjashtoheshin vetëm të krishterët dhe çifutët. Të krishterët që banonin brenda kufijve të perandorisë ndaheshin sipas saj, në dy kombësi: ortodoksët, duke përfshirë edhe shqiptarët, në bazë të marrëveshjes së lidhur në vitin 1454, midis sulltan Fatihut dhe Patrikut të Konstandinopojës, konsideroheshin rumë⁵, në vështrimin e kombësisë bizantine, me nënkuptimin e kombësisë greke. Katolikët, përfshirë edhe shqiptarët, përkundrazi trajtoheshin si pjesëtarë të kombësisë latine⁶, në vështrimin e banorëve europianë të varur fetarisht nga Roma.

Pikërisht, ky diferencim që zbatonte Porta e Lartë ndaj popullsisë së saj peshoi rëndë mbi gjeopolitikën e shqiptarëve dhe perceptimin që formuan disa të huaj mbi identitetin kombëtar shqiptar. Madje, jo vetëm tek të huajt, por aty-këtu dhe brenda në Shqipëri.

Me fushatën ideologjike që ndërmori Porta e Lartë pas mesit të shekullit XIX për ta zbatuar te banorët myslimanë të Shqipërisë këtë koncept për kombin, e shoqëruar me fushatën që ndërmori kisha fanariote e Stambollit, prapa së cilës vepronte qeveria e Athinës, për të bindur shqiptarët ortodoksë se i takonin kombësisë greke, e shoqëruar edhe nga përpjekjet e misionarëve të kishës perëndimore, të cilët u përpoqën të rrënjosnin te besimtarët e tyre konceptin se shqiptarë qenë vetëm besnikët e tyre katolikë, në tërësi ndikuan dhe në vetë identitetin kombëtar të shqiptarëve. **U krijua kështu ajo që rilindësi i shquar, Sami Frashëri, quante aleancë midis koncepteve politike**

⁴ Në turqisht "osmanli millet".

⁵ Në turqisht "rum millet".

⁶ Në turqisht "latin millet".

të fuqive europiane dhe ideologjisë osmaniste të Perandorisë Osmane dhe platformës së “Megali idesë” greke, të cilat bashkërisht mohonin dy të drejtat themelore të kombit shqiptar – të drejtën e përkatësisë së mbarë shqiptarëve në një komb të vetëm, dhe mohimin e shqiptarëve si subjekt i të drejtave kombëtare, pra, të drejtën e tyre për të formuar një shtet kombëtar të pavarur, qoftë edhe në një vilajet të vetëm autonom.

Pikërisht, për të përmbysur këtë platformë që ndillte shuarjen e kombit shqiptar, u ngrit Rilindja Kombëtare Shqiptare. Pra, thelbin e Rilindjes Kombëtare Shqiptare e përbënte lufta për të mbrojtur identitetin kombëtar shqiptar nga prurjet joshqiptare që sillnin në trupin e **kombit ndikimet që vinin me mbulesë fetare nga jashtë.**⁷

Si rrjedhojë e pushtimit dhe e sundimit katërshekullor osman, shqiptarët hynë në historinë moderne të ndarë në tri besime të ndryshme fetare. Krahas feve të mëparshme katolike e ortodokse, të cilat i ruajti një pjesë e popullsisë, u shtua edhe ajo myslimane, së cilës, me kalimin e kohës, i përkisnin shumica e shqiptarëve.⁸

Kështu, ndërgjegjja fetare e besimtarëve shqiptarë sundohej nga tri institucione fetare, që u përkisnin tri shkollave dhe tri kulturave të huaja. Këto institucione klerikale vareshin nga tri qendra universale të huaja. Konkretisht, myslimanët vareshin nga Kalifati sulltanor, ortodoksit nga Patrikana fanariote dhe katolikët nga Papati roman. Dy të parat, Kalifati sulltanor dhe Patrikana fanariote jo vetëm nuk e kanë përkrahur, por edhe e kanë luftuar vazhdimisht **idenë e një shteti kombëtar shqiptar.**

Por ndryshe nga “praktika” ballkanike, popullsia shqiptare nuk u nda në aq kombësi, sa edhe fe. Ndërgjegjja e kombësisë shqiptare nuk u dominua

⁷ Prof, Dr. Kristo Frashëri: “ Identiteti i shqiptarëve”, burim i cituar.

⁸ Në fund të shekullit XV, kemi “një det të krishter me disa ishuj të vegjel mysliman. Këta ishuj ishin vetëm në disa qytete, ku u zbatua politika e kolonizimit. Në fund të shekullit XVI, popullsia e qyteteve dhe kështjellave ishte rreth 62% e krishtere dhe 38% ishte konvertuar në fenë islame. Edhe pothuajse një shekull pas pushtimit, procesi i konvertimit të krishterëve në mysliman ishte zhvilluar me hapa të ngadalte. Në shekullin e XVII fillon një shtrirje masive e fesë islame në një pjesë të mirë të trojeve shqiptare. Në përgjithësi në fund të shekullit XVII popullsia myslimane duhet të jetë mbi 70%.(Për me tepër shih: Xhavit Shala:“Albanians in the crossroads „ p.17

asnjëherë nga ajo fetare. **Në popullsinë shqiptare mbizotëronte ndjenja e kombësisë.** Ndërmjet besimtarëve të komuniteteve të ndryshme fetare të vendit u ruajtën lidhjet shpirtërore, ekonomike e shoqërore, madje edhe lidhjet familjare.⁹ Me këtë shpjegohet dhe fakti që shqipëtarët nuk njohën asnjëherë grindje e luftëra të brendshme fetare. **Megjithatë, ndarja e shqiptarëve në tri besime fetare, të cilat vareshin nga institucione të huaja klerikale, si dhe politika e përçarjes fetare, e ndjekur ndaj shqiptarëve prej këtyre qendrave, e vështirësuan bashkimin e popullit shqiptar dhe u bënë pengesë në luftën e tij për çlirimin kombëtar.** Kjo përbën njërin ndër faktorët që ngadalësuan procesin e emancipimit politik dhe të zgjimit kombëtar të shqiptarëve.

Në këto kushte, Lëvizja Kombëtare Shqiptare, ndryshe nga vendet e tjera të Ballkanit, **nuk mund të përdorte urrejtjen fetare ndaj pushtuesit si motiv për të angazhuar popullin në luftë.** Bashkimi i shqiptarëve në luftën çlirimtare do të arrihej jashtë fesë, mbi fenë dhe vetëm i mbështetur në parimin e kombësisë. Kjo mund të përmbledhet në thënien e famshme të Pashko Vasës se “Feja e shqiptarit është shqiptaria”. Pra, për shqipëtarët, lufta për çështjen kombëtare, e cila ishte e përbashkët për të gjitha lëvizjet kombëtare ballkanike, pati veçoritë e saj. Ajo nuk pati asnjëherë motiv fetar. **Ajo u ngrit jo vetëm jashtë fesë, por u drejtua njëherazi kundër identifikimit të përkatësisë fetare të elementëve të ndryshëm të popullsisë shqiptare me atë kombëtare¹⁰** dhe e zhveshi ndarjen fetare nga petku politik. Kjo është një nga dhuratat më të shenjta që rilindësit tanë i bënë Shqipërisë dhe kombit shqiptar. Vlerat e kësaj zgjidhjeje, ndonëse të detyrueshme për atë kohë, janë të jashtëzakonshme sot në kohët moderne.

⁹ Me këtë shpjegohet prania e sinkretizmit fetar të përfaqësuar nga “Iaramanët” (të krishterët e fshehtë), përhapja e gjerë e bektashizmit me doktrinat e tij liberale dhe fakti që Shqipëria nuk njohu asnjëherë grindje e luftëra fetare.

¹⁰ Rilindja Kombëtare u ndesh edhe me konceptet fetare mbi kombin. Parimi “Feja e shqiptarit është shqiptaria”, që përshkon një literaturë të tërë politike e artistike të periudhës së Rilindjes, ishte pa dyshim afetar, por jo antifetar, një parim politik, që synonte bashkimin e shqiptarëve, pavarësisht nga përkatësia e tyre fetare. Ky koncept i shqiptarisë si feja e shqiptarëve pushtoi gjatë epokës së Rilindjes mendjet e zemrat e shqiptarëve, duke u bërë një forcë ideore, që bashkoi shpirtërisht e mendërisht shqipëtarët në luftën për çlirimin kombëtar.

Këto përbëjnë sot themelet e harmonisë dhe tolerancës fetare të shqiptarëve.

Jo në pak raste autoritete fetare shqiptare janë angazhuar në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare me penë apo pushkë. Por asnjëherë nuk kanë luftuar në emër të fesë së tyre. Ata janë angazhuar në këtë luftë jo për motive fetare, por për ideale kombëtare.

Përkundrazi, për rolin që luajti feja në lëvizjet kombëtare të shteteve të tjera ballkanike, këto kombe sot po paguajnë haraçin dhe nuk po e çlirojnë dot politikën e tyre nga rivaliteti i fesë. Në Serbi sot fjala e kishës është shumë e rëndësishme, gati vendimtare. Politikanët atje janë në kërkim të një gjuhe të përbashkët me kishën.¹¹ Po kështu dhe në Greqi. Feja atje ka një pushtet jo më të vogël se mullahët në Iran.¹² Kisha Ortodokse Greke ka mbajtur vazhdimisht gjallë pretendimet greke për Vorio-Epirin. Me parimin e saj të fesë-komb, kjo kishë ka punuar dhe po punon, në bashkëpunim me segmente të politikës greke, për greqizmin e popullsisë ortodokse të Shqipërisë.

Pra, harmonia dhe toleranca fetare e shqiptarëve si vlera thujtë unike kombëtare fetare, u krijuan në shekuj, paralelisht dhe pazgjidhshmërisht me Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, nën kujdesin e veçantë të rilindasve tanë dhe në kushte specifike, të ndryshme nga kombet e tjera në Ballkan.

3. Harmonia ndërfaqetare është vlerë jona kombëtare fetare, por njëkohësisht është dhe një vlerë demokratike dhe evropiane.

Modeli shqiptar i harmonisë ndërfaqetare është një nga thesarët më të vyer të kulturës e të trashëgimisë sonë kombëtare, të krijuar nga kombi ynë në shekuj, nëpërmjet manifestimit, zhvillimit dhe përcjelljes ndër breza të një

¹¹ Ata dëshirojnë të flasin njëzëri, pasi janë të vetëdijshëm se kisha shihet si mbrojtëse historike e interesave të popullatës. Jo vetëm politika, por edhe mediat apo pushteti i katërt, siç njihen ndryshe, duken të nënshtruara përballë pushtetit të kishës. Ato nuk guxojnë të kundërshtojnë pohimet dhe deklaratat e kishës apo të informojnë ndryshe opinionin serb. Është gati e pamundur që në shtypin serb të gjenden qëndrime të individëve dhe të institucioneve në kundërshtim me këndvështrimin e kishës (Tanja Matić në Beograd, Deçan dhe Belo Polje: "Kisha kërkon të ketë fjalën e fundit në çfarëdo marrëveshje", botim i IWPR)

¹² Për më tepër, shih: Xhavit Shala, "Greqi, kush mbjell erën, korr furtunën". Botuar në gazetën "Shqip" datë 22.12.2008 dhe në www.acnss.com

tolerance fetare, të denjë për një komb të lashtë dhe të qytetëruar europian. Qenia në themel të identitetit kombëtar të shqiptarëve jo i fesë, por i gjuhës, traditës e kulturës; prania e një feje islame, përgjithësisht, popullore dhe e zbutur nga bektashizmi; urrejtja dhe lufta kundër rrymave intolerante në islam, siç është vahabizmi; ftohja e detyruar e brezit të ri të shqiptarëve ndaj fesë gjatë regjimit komunist; moskthimi i konflikteve ekonomike e shoqërore në konflikte fetare, si dhe tradita e forcave politike shqiptare, që, historikisht, nuk kanë synuar të krijojnë një elektorat mbi baza fetare, janë disa nga faktorët që i kanë ruajtur besimet tradicionale fetare të shqiptarëve nga fanatizmi, ekstremizmi apo fundamentalizmi fetar dhe që e kanë çimentuar harmoninë dhe tolerancën tonë fetare.

Por, thesaret e kulturës së një kombi janë gjithmonë të rrezikuara, nëse nuk kujdesesh për to, nëse nuk identifikon faktorët që i kërcënojnë dhe nëse nuk investon për të neutralizuar efektin këtyre faktorëve. Edhe harmonia e toleranca ndërfitare, si thesare të kulturës sonë kombëtare, ndonëse janë krijuar dhe kanë rezistuar në shekuj, duhen sigurizuar, pra duhen trajtuar si pasuri të rrezikuara.¹³

4. Harmonia ndërfitare është një vlerë e sigurizuar, që do të thotë e mbrojtur, që në pavarësimin e Shqipërisë.

Shteti shqiptar, menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, megjithëse i brishtë, e vlerësonte harmoninë fetare dhe, në përgjithësi, çështjet fetare si shumë të rëndësishme për sigurinë kombëtare. Në vitin 1923, Visarion Xhuvani, i cili

¹³ Xhavit Shala: Pjesë nga referati i mbajtur me datë 26. 05. 2007, në simpoziumin: "Domosdoshmëria e Dialogut Ndërfetar e Ndërkulturor për Paqen Botërore". Bashkëorganizues i këtij simpoziumi ishte dhe Qendra Shqiptare e Studimeve për Sigurinë Kombëtare. Duke shfrytëzuar momentin që në këtë simpozium do të ishin pjesëmarrës dhe drejtues të komuniteteve fetare nga të gjitha trojet shqiptare, autori nëpërmjet këtij referati ka synuar të tërhiqte dhe vëmendjen e tyre për domosdoshmërinë e ruajtjes dhe promovimit të tolerancës fetare dhe për rreziqet që kanosen asaj. Në këtë simpozium ishin të ftuar akademikë e autoritete fetare nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia. Shkrimi u botua dhe në numrin 34 të revistës "Mapo":

(<http://revistamapo.com/print.php?faqe=detail&kat=Kulture&id=521&PHPSESSID=d05d2a2578d0e56c9f75221fea978976&PHPSESSID=d05d2a2578d0e56c9f75221fea978976>) dhe në të përditshmen "Koha jonë", 5 qershor 2007, si dhe në faqen elektronike të Qendrës Shqiptare të Studimeve për Sigurinë Kombëtare:

(<http://www.acnss.com/html/studime/0809siguria.htm>)

më vonë bëhet kryepeshkop i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, shprehet: “Të gjithë e dimë që çështjet fetare kanë qenë dhe janë gjithnjë të ngatërruara këtu. Të gjithë e dinë se sa i kanë kushtuar shtetit. Mos e dhëntë Zoti të bëhen vegla dhe për të ardhmen”¹⁴. Nisur nga këto rrethana specifike, patrioti e shtetari tjetër Mehdi Frashëri, porosiste që “Qeveria duhet të jetë pak më brenda në fetë...”¹⁵.

Sanksionimi i parimeve të tilla, si laiciteti i shtetit, liria e besimit fetar dhe e ndërrimit të tij, trajtimi i barabartë i besimeve fetare, përcaktimi në detaje i mënyrës së emërimit të primatëve të besimeve fetare, i financimit të këtyre komuniteteve, do të ndikonte pozitivisht në konsolidimin e tolerancës fetare të popullit tonë dhe, për rrjedhojë, edhe në forcimin dhe sigurinë e vetë shtetit shqiptar. Që në atë kohë, patriotët shqiptarë janë përpjekur të përhapin frymën që besimet fetare, pavarësisht nga pesha në numër, të trajtoheshin, të përfaqësoheshin dhe ta ndienin veten të barabartë. Kjo ka qenë dhe mbetet shtylla e dialogut ndërfetar dhe e tolerancës fetare të shqiptarëve.

Pikërisht, për këtë specifikë të besimeve fetare të shqiptarëve, problemet që mund të ketë brenda Bashkësitë Islame, nuk mund të jenë vetëm të tyre, por të gjithë popullit shqiptar, ashtu sikurse problemet në komunitetin ortodoks, katolik apo bektashi, nuk mund të jenë vetëm problemet e tyre, nuk mund të shqetësohen vetëm ata, por janë probleme të të gjithë shqiptarëve. Kemi të drejtë dhe me të drejtë shqetësohemi të gjithë. Kjo përbën një tjetër shtyllë të dialogut dhe tolerancës ndërfetare në vendin tonë.

5. Islamizmi shqiptar ka luajtur një rol kryesor në krijimin e tolerancës fetare shqiptare.

Nga rreziqet nuk është i imunizuar asnjë nga komunitetet fetare tradicionale të shqiptarëve. **Islamizmi**, si besim fetar në shumicë te

¹⁴ AQSH, Fondi. 246, D- 68, Fl. 471, viti 1923.

¹⁵ Po aty, faqe 637.

shqiptarët, ka luajtur një rol kryesor në krijimin e një prej vlerave mjaft të rëndësishme të kombit shqiptar dhe të shoqërisë shqiptare, tolerancës fetare. Islami me të vërtetë është fe universale, por edhe popujt, që historia i ka lidhur me atë besim fetar, arrijnë t'i japin atij disa tipare të veçanta. Duke qenë prezent në trojet shqiptare, në një vend europian, për rreth 500 vjet, islamizmi ka marrë tiparet e një islamizmi europian, jo kopje e plotë e atij arab. Kjo nuk do të thotë se feja islame është nacionalizuar, ajo përsëri është fe universale, por me disa tipare autoktone, të pranueshme dhe nga Europeanët.

Jo rrallë sot dëgjojmë thirrjet për ruajtjen e islamit autokton. Në të vërtetë, ato pasqyrojnë shqetësimet e herëpashershme që janë pasqyruar dhe në shtypin shqiptar, lidhur me përpjekjet që po bëjnë rrymat ekstremiste, si vahabi-selefizmi, për të depërtuar në islamin ballkanik e atë shqiptar. Kjo rrymë fetare fundamentaliste është e papranueshme dhe nga shumë shtete të tjera me popullsi në shumicë myslimane. Thirrja për islamin autokton nuk është thirrje që shqiptarët të heqin dorë nga feja e tyre, por ta ruajnë atë nga mishi i huaj.

Përpjekjet kundër islamit autokton, si besimi më i madh në numër i shqiptarëve, janë përpjekje direkte kundër vlerave fetare kombëtare të shqiptarëve, kundër harmonisë dhe tolerancës fetare, me pasoja dhe në sigurinë tonë kombëtare. Nuk duhet të harrojmë përpjekjet dhjetërvjeçare të qarqeve sllavo-ortodoksë për t'i paraqitur shqiptarët myslimanë njëlloj si arabët, si mish i huaj në Ballkan dhe në Europë, propagandë kjo e intensifikuar sidomos në prag të përcaktimit të statusit përfundimtar të Kosovës.

Por, harmonia dhe toleranca fetare janë rrezikuar. "Me gjithë traditën tolerante në çështje fetare, shoqëria është ekspozuar ndaj një numri ndikimesh të jashtme, ndërkohë që forma të Islamit dhe të Krishterimit, që janë të reja për vendin, kërkojnë të hedhin rrënjë".¹⁶ Importimi në mënyrë të

¹⁶ Pjesa për Shqipërinë, të Raportit Ndërkombëtar mbi Lirinë Fetare, për vitin 2005, raport që hartohet dhe publikohet çdo vit nga qeveria e SHBA, në funksion të politikës së saj për promovimin e të drejtave të njeriut në botë.

pakontrolluar i një sërë sektesh e rrymash fetare, të cilat çënojnë të drejtën e shqiptarëve për të ushtruar besimet e tyre tradicionale fetare, sekte e rryma prej të cilave frikësohen edhe shtete me demokraci të konsoliduar, kërkon një rol në rritje të vetë komuniteteve tradicionale fetare të shqiptarëve, të intelektualëve shqiptarë e sidomos të strukturave ligjzbatuese. Është detyrë e tyre që jo vetëm të respektojnë lirinë e besimeve fetare, por edhe të mos lejojnë që abuzimi me këto liri të çënojë sigurinë tonë kombëtare.

Depërtimi i sekteve dhe i rrymave të rrezikshme fetare është bërë, kryesisht, nëpërmjet organizatave të huaja joqeveritare të spektrit fetar. Krizat dhe destabiliteti politik, social, ekonomik, financiar që ka përjetuar vendi ynë gjatë tranzicionit (vitet 1991, 1992, janar-mars 1997, shtator 1998), të shoqëruara me mungesën e shtetit ligjor dhe me cënime të rënda të rendit dhe sigurisë; mungesa e financimeve nga shteti dhe shpresa të ndihmat që vinin nga jashtë; mungesa e një ligji për komunitetet fetare; pozicioni i përshtatshëm gjeografik i Shqipërisë midis Lindjes dhe Perëndimit; mungesa e strukturave efikente shtetërore që të merreshin me menaxhimin e raporteve ligjore dhe të detyrimeve të ndërsjella të shtetit me komunitetet fetare janë disa nga faktorët që i lanë hapësirë ardhjes në Shqipëri të sekteve e lëvizjeve fetare, veprimtaria e disa prej të cilave është e ndaluar me ligj në shumë shtete.

Shumë nga këto OJQ të dyshimta, duke shfrytëzuar vakuumin ligjor dhe mangësitë në edukimin fetar, synuan moshat e reja dhe kryesisht fëmijët.

Dhënia fëmijëve dhe adoleshentëve të njohurive të shtrembëruara për një besim fetar, shumë herë përjashtuese për besimet e tjera fetare, të kushtëzuara në disa raste me ndihma ekonomike, të ofruara nga organizata me origjinë dhe financime të dyshimta, e bën këtë kontigjent fëmijësh lehtësisht të manipulueshëm për t'u përdorur për veprime antiligjore dhe një kërcënim serioz për tolerancën fetare të vendit tonë.

Duke shfrytëzuar programet e tyre për shkollimin apo të vizitave të rinjve jashtë shtetit, OJQ-të e dyshimta u krijojnë mundësi organizatave terroriste të dërgojnë për studime kandidatura që i kanë përzgjedhur për të zgjeruar

radhët e tyre dhe të realizojnë rekrutimin e trajnimit të tyre edhe në kurse ushtarake. Procesi i zhvilluar në Egjipt për disa anëtarë të Celulës së Xhihadit Islamik Egjiptian, të arrestuar në Shqipëri, apo siç është njohur ndryshe dhe procesi për «Arabët e Shqipërisë» tregoi se organizatat terroriste, duke përdorur si koperturë OJQ-të arabe, kanë bërë rekrutime nga radhët e studentëve të dërguar prej tyre për studime jashtë shtetit.¹⁷ Ata, tashmë, janë «të konservuar» dhe mund të vihen në veprim kur ta kërkojë situata. Pjesëtarë të këtyre organizatave kanë inspiruar dhe kanë mbajtur kontakte të vazhdueshme me eksponentë të lëvizjes vehabi-selafi në vendin tonë. Dhe frytet nuk vonuan. Në ditët e sotme, disa ish- nxënës të shkolluar me financimet e OJQ-ve të dyshimta janë bërë protagonistë të sulmeve ndaj përfaqësuesve legjitimë të komunitetit mysliman dhe nxitës të përçarjeve në atë komunitet¹⁸.

Të gjithë duhet të bashkëpunojnë për të neutralizuar rrezikun e depërtimit të ekstremizmit në komunitetet tona fetare. Është për të ardhur keq që në këto vite të pluralizmit, ligjvënësit shqiptarë, nuk u angazhuan si paraardhësit e tyre patriotë, në rikrijimin e asaj infrastrukture të domosdoshme ligjore për të mbrojtur nga rreziqet besimet fetare shqiptare. U hoq cdo mbështetje shtetërore materiale ndaj fesë. Heqja e të gjithë mbështetjes shtetërore ndaj fesë, në të vërtetë, nuk mund të jetë pjesë e programit të një qeverisjeje demokratike.

Për këtë, ligjvënësit shqiptarë duhet të bëjnë që shteti i tyre të kalojë nga pozicioni i neutralitetit pasiv¹⁹ i këtyre viteve, në atë të laicitetit veprues, pasi harmonia fetare, sa ç'është madhështore si ngrehinë, aq është edhe e

¹⁷ Sipas Ahmet Ibrahim Al Nagar, njëri nga drejtuesit e Celulës së Xhihadit Islamik egjiptian të arrestuar në Shqipëri: «Janë rekrutuar shumë të rinj nga e gjithë Shqipëria. Këta djem ishin shumë pasionantë e revolucionarë, madje, më aktivë se eksponentët kryesorë të xhihadit, të gatshëm për të luftuar në çdo moment... Këta djem janë të gatshëm për të rrëzuar qeverinë shqiptare...».

¹⁸ Myslimanët, 1000 firma kundër krerëve në Tiranë - «Gazeta Shqiptare», 18 nëntor 2004, f. 17.

¹⁹ Xhavit Shala, «Siguria Kombëtare dhe sfidat e integritetit», f. 107. Tiranë, maj 2003. Botim i Qendrës Shqiptare të Studimeve për Sigurinë Kombëtare.

brishtë. Mjafton e çara e parë serioze, radikalizimi i njërit prej besimeve, që ngrehina të shembet, thotë shkrimtari ynë i madh Ismail Kadare²⁰.

Legalizimi dhe përfshirja e edukimit fetar në sistemin arsimor publik, duke respektuar laicitetin e shtetit dhe shekullaritetin e shkollës, është një investim për mbrojtjen e tolerancës fetare në vendin tonë. Gjithashtu, shteti duhet të gjejë zgjidhje, të planifikojë dhe të financojë një Fakultet Teologjik, për përgatitjen e klerikëve të lartë të katër komuniteteve kryesore fetare dhe të zgjidhë problemin për nivelet e tjera të arsimit fetar. Do të ishte me interes ngritja e një qendre kombëtare ku të përgatiteshin kuadrot e lartë fetarë në shkallë kombëtare, për Shqipërinë, Kosovën, Maqedoninë e Malin e Zi. Do të ishte e rrezikshme për sigurinë tonë kombëtare lënia e edukimit fetar dhe përgatitjes së kuadrove fetarë në duart e shoqatave apo të fondacioneve të huaja.

Shqiptarizimi i hierarkisë fetare është një faktor tjetër që do t'i shërbejë ruajtjes së harmonisë dhe tolerancës fetare në vendin tonë. “Nuk i bëhet kurrë një shërbim më i mirë fesë prej të huajit, sesa prej popullit të vet. Sepse feja është fjala. Kur fjala nuk flitet e qartë, kur nuk flitet si flet populli, atëherë populli nuk e kupton. Të jesh filozof sa të duash, kur flet një gjuhë tjetër, asgjë nuk përçohet në popull”, shprehej në një të përditshme shqiptare para se të vdiste At Zef Pllumi²¹, një nga klerikët më të persekutuar gjatë regjimit komunist.

6. Tendenca për radikalizimin e fesë islame ndër shqiptarët është mbështetur dhe sponsorizuar dhe nga shërbimet sekrete antishqiptare.

²⁰ Ismail Kadare, Fjala në Konferencën Ndërkombëtare «Fetë dhe qytetërimet në mijëvjeçarin e ri - Rasti i Shqipërisë, mbajtur në Tiranë, 13-14 nëntor 2003.

²¹Në një intervistë dhënë gazetës “Shekulli”, më datë 23.12.2005, të titulluar “Shqipëria e pushtueme prej priftërinjve të huaj”, At Zef Pllumi, françeskani 82-vjeçar, i dënuar në burgjet komuniste, shpreh shqetësimin për rritjen e paarsyeshme të drejtuesve të huaj të Kishës Katolike, gjë që, sipas tij, nuk ka ndodhur kurrë më parë që në Shqipërinë e Buzukut, Budit, Bogdanit dhe Kazazit. Ai kritikon Vatikanin, qeverinë shqiptare, por edhe shoqërinë që nuk reagon ndaj këtij sundimi të vërtetë të klerikëve të huaj, të cilët prej 15 vjetësh nuk u flasin më shqip besimtarëve./ Intervista e At Zef Pëllumbit është botuar në numrin 16 të përjavshmen shqiptare “ABC”.

Edhe më parë, burime të besueshme të komunitetit të shërbimeve tona ligjzbatuese, kanë raportuar raste kur shërbimet sekrete serbe kanë nxitur veprimet radikale në besimet tona fetare. Ato kanë vite që e nxisin këtë radikalizim dhe propagandojnë rrezikun e islamit radikal ndër shqiptarët në Ballkan. Qarqe të caktuara serbe kanë pasur një strategji që besimin Islam të shqiptarëve ta përdornin për të krijuar tek perëndimorët një perceptim negativ ndaj shqiptarëve. Nën regjimin serb, ishte më e lehtë të merrje një leje për të ndërtuar një xhami se sa për të ndërtuar një shkollë në gjuhën shqipe.

Duke u përpjekur që ta paraqesin kauzën shqiptare si një kauzë fetare, dhe jo kombëtare, serbët synonin t'i kthenin shqiptarët në një burim frike për Evropën, ndërsa veten si mbrojtës të krishterimit. Kjo ishte një strategji për të cilën ata punuan me dekada të tëra. Në këtë mënyrë kur shqiptarët të bëheshin objekt i dhunës, projektuesit e kësaj strategjie serbe mendonin se evropianët nuk do të përfshiheshin, pasi ky do të ishte një konflikt fetar për të cilin dhe ata vetë do të ishin të shqetësuar.

Synimi i tyre më pas ishin të komprometonin përpjekjet e Kosovës për pavarësi dhe ta mënjanonin opsionin e pavarësisë si një zgjidhje për stabilitetin e Europës. Strategjia serbe, me sa duket, përfshinte që nga angazhimi i shërbimeve të fshehta e deri te propaganda në media. Përpjekjet e qarqeve të caktuara serbo-ruse për t'i paraqitur myslimanët shqiptarë si arab ekstremistë, si mish i huaj në Evropë, të lidhur dhe me të ashtuquajturin terrorizëm islamik dështuan. Shpallja e pavarësisë së Kosovës dhe mbështetja e saj nga shtetet më demokratike të botës tregoi më së miri këtë.

Pavarësisht propagandës serbe, kancelaritë perëndimore e dinë se besimi fetar islam është një fe paqësore, siç janë dhe besimet e tjera fetare, që nuk ka të bëjë fare me të ashtuquajturin terrorizëm islamik. Ata e dinë gjithashtu se **goditja më e madhe që mund t'i jepet luftës kundër terrorizmi, është ta islamizosh atë.** Një besim fetar në tërësi nuk mund të ushqejë terrorizmin, ndonëse në të gjitha besimet fetare gjen elementë radikalë e ekstremistë.

Ruajtja dhe promovimi i tolerancës dhe harmonisë ndërfaqetare është një investim për gjeopolitikën e shqiptarëve dhe sigurinë kombëtare. E tillë duhet konsideruar e vlerësuar ajo jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë dhe në viset shqiptare në Maqedoni e në Malin e Zi.

Në kushtet e sotme është i domosdoshëm identifikimi i faktorëve që përbëjnë kërcënim për tolerancën dhe harmoninë tonë ndërfaqetare dhe duhen marrë masat e nevojshme për neutralizimin e këtyre faktorëve.

Një nga këta faktorët është vehabizmi dhe tendeca e tij për të goditur islamin autokton e radikalizuar besimin islam të shqiptarëve.

7. Vehabizmi dhe “Vëllazëria Myslimane” synojnë arabizimin, radikalizimin dhe politizimin e islamit ballkanik.

Në të vërtetë, vahabizmi, si lëvizje fetare, nuk ka patur si shënjestër vetëm myslimanët shqiptarë. Depërtimi në islamin ballkanik është një strategji e përpjekjeve të kahershme e vehabizmit. Pra, synimi i tyre nuk kanë qenë thjesht shqiptarët. Synimi i tyre është marrja e kontrollit të strukturave të Bashkësive Islame edhe në Bullgari, Bosnje, Sanxhak, Maqedoni e Kosovë. Fatkeqësisht, edhe në Kosovë e Maqedoni, duke përfitur nga varfëria dhe papunësia e madhe, nëpërmjet OJQ-ve kanë depërtuar në përmasa të rrezikshme. Sipas këtyre rrymave, myslimanët e Ballkanit e kanë deformuar fenë islame dhe ka kohë që janë larguar nga islami i vërtetë. Kështu ata nxisin edhe konfliktin midis brezave. Djemtë kundër etërve të tyre.

Edhe “Vëllazëria Myslimane”, e cila ngre tezat e saj mbi islamin radikal si një platformë politike, përndryshe krahu politik i vehabi-selefizmi, po tenton shtrirjen dhe politizimin e islamit në vendet myslimane ish-komuniste²²,

²² Përhapja e rrymave të tilla të importuara u bë shqetësuese edhe në trojet shqiptare jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë. Siç shkruan teologu Nexhat Ibrahim në shkrimin “Kush po manipulon me fatkeqësinë e besimtarëve myslimanë të Kosovës”: “izmat e aktualizuara kohët e fundit në Kosovë, por edhe në Shqipëri dhe Maqedoni si selefizmi, vahabizmi... paraqitja nëpër xhami në emër të fesë së pastër e mjekrave të gjata, të gjera dhe të pakontrolluara, në emër të asaj se kjo e reja qenka burimore, janë treguesit më të mirë se nga ecën çështja” - «Dituria Islame» Nr.137, nëntor 2001.

përfshirë dhe Ballkanin. Këtu ajo ka depërtuar nëpërmjet një rrjeti të tërë të OJQ-ve arabe.

8. Vehabi-selefizmi është rrezik për demokracinë shqiptare, shtetin e të drejtës, të drejtat e njeriut dhe për vetë sigurinë tonë kombëtare.

Sot nuk është antiligjore të jesh vehabit, ajo është zgjidhje personale. Por që nga momenti që ata organizohen dhe përpiqen t'u imponohen të tjerëve, përbën një rrezik që duhet sigurizuar.

Vehabizmi është një kërcënim për demokracinë në përgjithësi, pasi duan që të imponojnë rregullat e tyre, duke mos i pranuar rregullat e lojës në një rend demokratik. Ata nuk njohin dhe nuk respektojnë institucionet. Ato janë rryma në Islam që nuk e pranojnë një rend demokratik. Për ta shteti duhet të jetë i bazuar mbi ligjet e shenjta.

Por Shqipëria, Kosova dhe shqiptarët në Maqedoni janë të deklaruar për demokraci perëndimore, euroatlantike, ku respektohen liritë dhe të drejtat e njeriut. Në këtë mënyrë vehabi-selefistët bien ndesh dhe nuk kanë asgjë të përbashkët as me besimtarët myslimanë shqiptarë dhe as me shqiptarët si komb.

Ne nuk na lidh asgjë me vahabizmin. Bashkësitë Islame në hapësirat shqiptare janë përcaktuar dhe në "kushtetutat" e tyre se janë besnikë të islamit tradicional shqiptar, pra të shkollës juridike Hanifi.

Përkundrazi, vehabitë sot kanë bërë target myslimanizmin tradicional shqiptar. Ata janë përjashtues, jo vetëm për besimet e tjera fetare, si krishtërimi, por edhe për variantin e besimit islam që praktikojnë shqiptarët. Për ta janë të papranueshme simbolet dhe festat kombëtare që nuk përputhen me ato fetare. Prioritare, sipas tyre, është feja e pastaj kombi. Por për shqiptarët feja nuk është tipari përcaktues i identitetit të tyre kombëtar. Duke përcaktuar fenë si prioritare para kombit, vehabitët godasin identitetin tonë kombëtar. Ata për "internacionalizmin islamik" janë gati të sakrifikojnë jo vetëm myslimanizmin, por edhe kombin shqiptar.

Lënia e hapësirave të veprimit të kësaj rryme në fenë islame, në trojet shqiptare, tërthorazi do të thotë të ndihmohet propagandën antishqiptare të qarqeve më të errëta sllavo-ortodokse. Përkundrazi, ngushtimi i hapësirave të veprimit të vahabizmit do të ishte një kontribut i vyer, jo vetëm për myslimanizmin tradicional shqiptar, por dhe për gjeopolitikën e shqiptarëve në rajon, për integrimin e tyre euro-atlantik dhe për sigurinë tonë kombëtare. Bashkësitë Islame në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe Malin e Zi, sot ndodhen para një sfide dhe do të dinë të përcaktojnë vetë fizionominë e tyre në të ardhmen, por trajtimi siç duhet i kësaj sfide është një çështje që prek gjithë shoqërinë shqiptare dhe pozitën gjeopolitike të tyre në rajon. Prandaj këto rreziqe duhen sigurizuar jo vetëm nga bashkësitë fetare, por nga e gjithë shoqëria shqiptare. Serioziteti i kësaj çështjeje kërkon veprim efikas jo vetëm nga Bashkësitë Islame, por dhe nga shoqëria dhe agjencitë ligjzbatuese në Shqipëri e Kosovë, si dhe vëmendje të veçantë nga faktorët politikë shqiptarë në Maqedoni dhe në Malin e Zi. **Të gjithë së bashku duhet të shuajmë zjarrin vahabit përpara se ai të na djegë.**

Gjithashtu forcat politike shqiptare ne trojet shqiptare duhet haptazi dhe prerazi të distancohen nga ndonjë tendencë e segmenteve të caktuara të tyre për të përdorur politikisht Bashkësitë Islame apo komunitetet e tjera fetare. Siç e përmendëm dhe më lart tradita e forcave politike shqiptare, që, historikisht, nuk kanë synuar të krijojnë një elektorat mbi baza fetare, është njëri ndër faktorët e rëndësishëm që i kanë ruajtur besimet tradicionale fetare të shqiptarëve nga fanatizmi, ekstremizmi apo fundamentalizmi fetar dhe që e kanë çimentuar harmoninë dhe tolerancën tonë fetare.

9. Në përfundim unë dua të theksoj se, pavarësisht shqetësimeve që ngritëm, gjendja duhet parë me optimizëm.

Aktualisht, ka një ndërgjegjësim më të madh, jo vetëm të strukturave shtetërore, por dhe të vetë komuniteteve fetare, të intelektualëve dhe, në përgjithësi, të shoqërisë civile ndaj rasteve të raportuara si kërcënime të

tolerancës fetare apo tentativave të elementeve të diskutueshme, që përpiqen të infiltrojnë në emër të fesë.

Institucionet tona fetare kanë filluar të ndërgjegjësohen për domosdoshmërinë e ruajtjes së vlerave dhe të komuniteteve të veta fetare nga ndikimet e ndryshme që i kundërvihen traditës sonë fetare. Por është e domosdoshme që këtyre institucioneve t'u rritet pavarësia nga ndihmat ekonomike që vijnë nga jashtë. Kjo arrihet në dy mënyra: duke u kthyer atyre sa më shpejt pronat e sekuestruara gjatë regjimit komunist, si dhe duke u mbështetur pjesërisht financiarisht nga shteti derisa ato të mëkëmben ekonomikisht.

Shpreh bindjen se Bashkësitë Islame Shqiptare në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe diasporë si dhe intelektualët shqiptarë kudo që janë, i kanë kapacitetet e duhura për të mbrojtur besimin islam të shqiptarëve nga çdo tentativë arabizuese e radikalizuese.

Ju faleminderit për vëmendjen!

Shkup, 3 Shtator 2010

Kumtesën e plotë ne video mund ta gjeni në:

<http://share.shutterstock.com/share/received/welcome.sfly?fid=2fff5ef63769132f&sid=0AZsWrJq4aNWbjA#>